Asamblea e Jashtëzakonshme në prezencë të ortakëve të cilët përfaqësojnë quorumin e duhur për vlefshmërinë e saj, procedoi me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës. Ortakët e kësaj shoqërie, më datë 06.12.2003 kanë marrë vendim për të kontribuar në të holla dhe në natyrë, në operacionin e zmadhimit të kapitalit të shoqërisë TEGOLA EDIL CENTRO Sh.p.k., në të cilën zotëron 16% të kuotave. Për vlerësimin e kontributit në natyrë ana e Gjykatës së Shkallës së parë Tiranë janë caktuar ekspertët vlerësues për realizimin e tij. Asamblea e Jashtëzakonshme e Ortakëve më datë 26.01.2004 ka marrë vendimin për miratimin e raportit vlerësues, përsa i përket kontributit në natyrë të shoqërisë, i cili do të kalojë për zmadhim kapitali të Shoqërisë TEGOLA EDIL CENTRO. Kontributi në natyrë është i përbërë nga një terren 7500m<sup>2</sup> terren së bashku me ndërtesat e ndodhura mbi to dhe që përbëhet nga ish-kaldaja dhe makineritë e ndodhura në të, në momentin e zmadhimit të kapitalit të TEGOLA EDIL CENTRO do të kalojnë në pronësi të kësaj të fundit. Për të realizuar kontributit në masën 16%, Shoqëria do të japë një kontribut shtesë në të holla. Edil Centro do të përfaqësohet në Asamblenë e TEGOLA EDIL CENTRO sh.p.k., e cila do vendosë për zmadhimin e kapitalit të saj, nga administratori Z. Vaid Ruli.

***Për pikën e parë të rendit të ditës, Asamblea e Jashtëzakonshme e ortakëve miraton pjesmarrjen në operacionin e zmadhimit të kapitalit të shoqërisë TEGOLA EDIL CENTRO nëpërmjet kontributit në natyrë dhe në të holla, në total në masën 16% që do të vendoset në Asamblenë e TEGOLA EDIL CENTRO Sh.p.k. e cila do të mbahet më datë 03.12.2004.***

Asamblea procedoi me pikën e dytë të rendit të ditës. Në mbështetje me sa u vendos në pikën e parë të rendit të ditës, është e nevojshme caktimi i ekspertit kontabël të autorizuar, i cili do të hartojë raportin përkatës për përcaktimin e vlerës së pjesmarrjes në

*Leb Meru*  
Sash Meru

*Arif*  
Arif

*[Signature]*

operacionin e zmadhimit të kapitalit të shoqërisë TEGOLA EDIL CENTRO. Për këtë qëllim, **ortakët propozojnë caktimin nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë të ekspertes kontabëkl të autorizuar Znj. Sanie Tafa.**

Së fundi, ortakët morën në shqyrtim pikën e tretë të rendit të ditës. Ortaku i shoqërisë, Shoqëria FINEST S.p.A. ka vendosur të tërhiqet nga shoqëria duke shitur kuotat që ai zotëron në kapitalin themeltar në masën prej 10.4%. Për këtë qëllim ai ju'a ka ofruar kuotat e tij për blerje ortakëve të tjerë të shoqërisë. Shoqëria Vectis Ansalt, ortakë e EDIL CENTRO ka shprehur vullnetin e saj për blerjen e masës prej 10.4% të kuotave të kapitalit themeltar të FINEST S.p.A. Ortakët e tjerë janë dakort për realizimin e këtij operacioni shit-bletje kuotash ndërmjet dy ortakëve të shoqërisë. Për këtë qëllim dhe në mbështetje të nenit 45 të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare", do të lidhet dhe kontrata përkatëse e shit-bletjes së kuotave.

**Për pikën e tretë të rendit të ditës, Asamblea e Jashtëzakonshme e Ortakëve, miraton shitjen e kuotave nga ortaku i shoqërisë, Shoqëria FINEST S.p.A. në favor të ortakut tjetër të shoqërisë, Shoqëria VECTIS ANSALT.**

Ortakët, sipas pikës së katërt të rendit të ditës, propozojnë ndryshimin e dispozitës përkatëse të Statutit në përfundim të operacionit të shit-bletjes së kuotave.

#### **Kështu, Neni 8**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 745.000.000 lekë të ndara si më poshtë:

- Shoqëria "Sol. Int. Sh.p.k. zotëron 345,686 kuota ose 46.4% me vlerë 345,686,000 lekë.
- Shoqëria "FINEST" S.p.a. zotëron 77,397 kuota ose 10.4% me vlerë 77,397,000 lekë.
- Z. Vaid Ruli zotëron 15,488 kuota ose 2.1% me vlerë 15,488,000 lekë.
- Vectis Anstalt zotëron 281,082 kuota ose 37.7% me vlerë 281,082,000 lekë.
- Z. Antonio Nidoli zotëron 8,449 kuota ose 1.1341% me vlerë 8,449,000 lekë.
- Z. Leonardo Nidoli zotëron 8,449 kuota ose 1.1341% me vlerë 8,449,000 lekë.
- Znj. Sarah Nidoli zotëron 8,449 kuota ose 1.1341% me vlerë 8,449,000 lekë.



Ndryshon në këtë mënyrë:



#### **Neni 8**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 745.000.000 lekë të ndara si më poshtë:

- Shoqëria "Sol. Int. Sh.p.k. zotëron 345,686 kuota ose 46.4% me vlerë 345,686,000 lekë.
- Z. Vaid Ruli zotëron 15,488 kuota ose 2.1% me vlerë 15,488,000 lekë.
- Vectis Anstalt zotëron 358,479 kuota ose 48.1% me vlerë 358,479,000 lekë.
- Z. Antonio Nidoli zotëron 8,449 kuota ose 1.1341% me vlerë 8,449,000 lekë.
- Z. Leonardo Nidoli zotëron 8,449 kuota ose 1.1341% me vlerë 8,449,000 lekë.
- Znj. Sarah Nidoli zotëron 8,449 kuota ose 1.1341% me vlerë 8,449,000 lekë.

Në përfundim të mbledhjes Asamblea e Ortakëve, në mbështetje dhe me Statutin e shoqërisë dhe të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare",

  
Sarah Nidoli  


## VENDOSI:

- 1- Të miratojë pjesmarrjen në operacionin e zmadhimit të kapitalit të shoqërisë REGOLA EDIL CENTRO Sh.p.k. nëpërmjet kontributit në të holla dhe në natyrë në total në masën 16%, i cili do të vendoset në Asamblenë e jashtëzakonshme të Ortakëve të kësaj shoqërie që do të mbahet më datë 03.12.2004. Shoqëria EDIL CENTRO do të përfaqesohet në këtë Asamble nga Z. Vaid Ruli.
- 2- Të propozojë caktimin nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë të ekspertes kontabël të autorizuar Znj. Sanie Tafa, e cila do të hartojë raportin . . . . .
- 3- Të miratojë shitjen e kuotave nga ortaku i shoqërisë, Shoqëria FINEST S.p.A. në favor të ortakut tjetër të shoqërisë, Shoqëria VECTIS ANSALT.
- 4- Të ndryshojë nenin 8 të Statutit në mënyrën e parashikuar si më sipër.
- 5- Ngarkohet administratori i shoqërisë për depozitimimin e këtij vendimi në Regjistrin Tregtar, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

## ORTAKËT

**SOL. INT. SRL**  
Përfaqësuar nga

**Augusto NIDOLI**

*Augusto Nidoli*

**Vaid RULI**

*Vaid Ruli*

**Sarah NIDOLI**

*Sarah Nidoli*

*Sarah Nidoli*

**VECTIS ANSTALT**  
Përfaqësuar nga

**Augusto NIDOLI**

*Augusto Nidoli*

**Antonio NIDOLI**

*Antonio Nidoli*

**Leonardo NIDOLI**

*Leonardo Nidoli*

*Leonardo Nidoli*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. 14244 Rep.

Nr. 1043 Kol.

## VËRTETIM

Sot, më datë 03.12.2004, para meje Agim Robo, Noter pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, u paraqitën personalisht:

**Z. Vaid Ruli**, me banim në Tiranë, rruga "Gjin Kuqali", Pallati 1, Shkalla 1, Apartamenti 8, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letër njoftimit me nr. EV 218089,

**Z. Leonardo NIDOLI**, i biri i Augustos, qytetar italian, lindur në Varese (Itali) më 18.05.1973, me vendbanim në Tiranë (Shqipëri), person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar,

**Dr. Augusto NIDOLI**, lindur në Addis Abeba më 11 Gusht 1941, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me cilësinë e përfaqësuesit të shoqërisë Sol. Int. Sh.p.k dhe VECTIS ANSALT.

**Znj. Sarah NIDOLI**, lindur në Varese (Itali) më 18.05.1973, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar,

**Z. Antonio NIDOLI**, më 21 Korrik 1971, me vendbanim në Tiranë (Shqipëri) në Rrugën Vangjel Noti, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

të cilët më kërkuan të bëj vërtetimin e nënshkrimeve të tyre në aktin e mësipërm, përpiluar në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, dhe unë noteri e vërtetoj atë sipas ligjit. Teksti ju bë i njohur ortakë në gjuhën italiane prej meje noterit.

NOTERI



REPubLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA TIRANE



N. 14525 Rep.

VERTETIM

Une i neneshkruari, Agim Xh. Robo, noter ne qytetin e Tiranes, Rruga Ismail Qemali, P. 27/1, vertetoj se kam perkthyer sa me siper nga italishtja ne shqip njelloj me origjinalin.

Tirane, me 13.12.2004

NOTERI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERËVE TIRANË**

Nr. 14237 Rep.

Nr. 1040 Kol.



**DEKLARATË NOTERIALE**

Sot në Tiranë në datë 02.12.2004 përpara meje Agim Xh. Robo, noter pranë Dhomës së Noterëve Tiranë u paraqit personalisht:

Dario MARCHELUZZO, shtetas italian, i datëlindjes 13.02.1947, me rezidencë në Costabissara, Vicenza, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. Y 134463, me cilësinë e ortakut themlues të shoqërisë "TEGOLA EDIL CENTRO" Sh.p.k., i cili me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë deklaron si më poshtë vijon:

Deklaruesi Dario Marcheluzzo është përfitues i kredisë së ceduar nga Shoqëria ZTZ Sh.p.k. në favor të tij, sipas marrëveshjes së datës 30.11.2004. Kredia në fjalë është rezultat i mbetjes së pashlyet të detyrimit që Shoqëria TEGOLA EDIL CENTRO Sh.p.k. ka kundrejt Shoqërisë ZTZ Sh.p.k., sipas kontratës së furnizimit me impiante industriale, detyrim i cili është në shumën prej 325.000 EURO. Përsa më sipër, Shoqëria TEGOLA EDIL CENTRO i detyrohet ortakut të saj Z. Dario Marcheluzzo për kthimin e kësaj kredie.

Sot Z. Dario Marcheluzzo deklaron se heqë dorë nga kthimi i kredisë, me qëllim që kjo shumë të kalojë për zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë TEGOLA EDIL CENTRO, në të cilën deklaruesi është ortak. Heqja dorë bëhet pa asnjë kusht paraprak.


Z. Dario Marcheluzzo e nënshkruan këtë deklaratë me vullnet të lirë dhe të pavesuar.

Kjo deklaratë redaktohet në 3 (tre) kopje, njëra mbahet nga noteri dhe të tjerat i jepen deklaruesit. Përmbajtja e deklaratës ju bë e njohur në gjuhën italiane deklaruesit nga unë noteri.

**DEKLARUES**

**Dario MARCHELUZZO**

*MARCHELUZZO DARIO*  
*Marcheluzzo Dario*







ZYRA E NOTËRISË  
Dr. Renato Facchin, notër në Schio

E lirë nga pulla sipas D.P.R. 26.10.1972, neni 5, tabela bashkëngjitur B)

Unë i nënshkruari Dr. RENATO FACCHIN, Noter në Schio, deklaroj se në datën e sotme kam vërtetuar firmat e vëna në aktin e mëposhtëm të

CEDIMIT TË KREDISË

Me anë të kësaj shkrese, e cila është e vlefshme sipas të gjitha efekteve të ligjit, ndërmjet të poshtë shënuarve:

Z.T.Z. MARCHELUZZO Sh.p.k., me seli ligjore në Caldogno, rruga Pomaroli nr. 63, me kapital të shoqërisë 49.590,00 EURO i derdhur i tëri dhe ekzistues, e regjistruar në Rgjistrin e Shoqërive të Vicenza me nr. 00193270246 (që i korespondon numrit të kodit fiskal) dhe pranë R.E.A. të të njëjtit qytet me nr. 216360 përfaqësuar nga Administratori i Deleguar dhe përfaqësuesi ligjor Z. Giancarlo Marcheluzzo, i lindur më Costabissara (VI) më 19 janar 1951, dhe me banim për arsye pune pranë Shoqërisë, i cili është auorizuar për këtë akt nga vendimi i Këshillit Administrativ të datës 30.11.20014,

Dhe

Dario Marcheluzzo, i lindur në Costabissara (VI) më 12 Shkurt 1947 dhe banues në Costabissara (VI), Rruga Cavour nr. 24, tregtar me kodin fiskal nr MRC DRA 47B13D107R,

Parashtrojnë:

Se Shoqëria Z.T.Z. MARCHELUZZO Sh.p.k. është kreditore e Shoqërisë TEGOLA EDIL CENTRO Sh.p.k., me seli në Tiranë, Rruga Gjergj Legisi, Laprakë, në shumën 325.000,00 EURO, nhatë cilat kanë mbetur 10%, që rrjedh nga kontrata e furnizimit me impiante industriale, e nënshkruar në datën 5 Shtator 2003, në lidhje me të cilën janë lëshuar dokumentet si më poshtë:

1. kopja e kontratës;
2. kopja e DDT;
3. kopja e faturës.

Se vetë Z.T.Z. MARCHELUZZO Sh.p.k. ka për qëllim t'i cedojë kredinë e mësipërme Z. Dario Marcheluzzo, me kushte që ky të bëhet titullar i vetëm dhe ekskluziv,

Bihet dakort dhe lidhet marrëveshja për sa më poshtë vijon:

1) Kredia e treguar në parashtrësë i cedohet *pro soluto* në datën e sotme Z. Dario Marcheluzzo, i cili e pranon.

2) Z.T.Z. MARCHELUZZO Sh.p.k., garanton ekzistencën e kredisë, por jo aftësinë paguese të debitorit, por deklaron se kredia është e sigurt, reale, në të holla dhe e kërkueshme.

3) Çmimi i këtij cedimi, sipas marrëveshjes së plotë të përcaktur nga palët kontraktuese në vlerën nominale 325.000,00 (treqinde enjëzet e pesë mijë) EURO, do të paguhet nga Dario MARCHELUZZO brenda por jo përtej datës 30 qershor 2006. - vazhdon

4) Z.T.Z. MARCHELUZZO Sh.p.k. i dorëzon përfituesit të cedimit, i cili nuk kundërshton marrjen, të gjithë dokumentacionin origjinal që provon kredinë në fjalë.

5) Z.T.Z. MARCHELUZZO Sh.p.k. angazhohet t'i njoftojë këtë cedim debitorit, nëpërmjet letrës recomande A.R., brenda dhe jo më larg se data 10.12.2004.

6) Shpenziemt që rrjedhin nga ky cedim, si edhe ato që kanë të bëjnë me njoftimin e tij, janë në ngarkim të Shoqërisë.

Akti në fjalë me regjistrim dhe inskriptim në zyrat kompetente.  
Schio, Rruga XX Shtator, 51, 30 Nëntor 2004.

Emër mbiemër dhe firma  
(vula)

REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA TIRANE

N. 1497 Rep.

VERTETIM

Une i neneshkruari, Agim Xh. Robo, noter ne qytetin e Tiranës, Rruga Ismail Qemali, P. 27/1, vertetoj se kam perkthyer sa me siper nga italishtja ne shqip njelloj me origjinalin.


Tirane, me 13.12.2004

NOTERI

Agim XH. ROBO



30387/2



**KËRKESË**

**KËRKUES:** Shoqëria Tregtare "TEGOLA EDIL CENTRO" sh.p.k., përfaqësuar nga administratori i Shoqërisë Z. Vaid RULI, madhor me zotësi të plotë për të vepruar.

**OBJEKTI:** Depozitimi i vendimit të Asamblesë së Ortakëve për zmadhimin e kapitali të Shoqërisë TEGOLA EDIL CENTRO Sh.p.k., dhe emërimin nga gjykata të ekspertës kontabël të autorizuar, datë 03.12.2004.

**PËRPARA GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË**

**TIRANË**

I nderuar Zoti Kryetar,

Shoqëria Tregtare "TEGOLA EDIL CENTRO" sh.p.k. është regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë me vendimin nr.30387, datë 14.10.2003 dhe ushtron aktivitetet e saj sipas akteve të themelimit.

Me cilësinë e Administratorit të shoqërisë, paraqes këtë kërkesë përpara kësaj gjykate për depozitimin e Vendimit të Asamblesë së Ortakëve, mbajtur më datë 03.12.2004.

Me anë të këtij vendimi, Asamblea e Ortakëve, ka vendosur zmadhimin e Kapitalit, të shoqërisë si dhe caktimin nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë të ekspertës kontabël të autorizuar për zmadhimin.

Ky vendim është marrë në bazë të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 ("Për Shoqëritë Tregtare" dhe Statutit të shoqërisë. Për këto arsye kërkojmë depozitimin e vendimit të mësipërm të Asamblesë së Ortakëve, datë 03.12.2004.

**KËRKUES**

**ADMINISTRATORI**

Vaid RULI


*Handwritten notes and signatures:*  
16.12.04  
Be  
Prokuror i Përgjithshëm  
Deklarati noteror  
N. 14237/1040  
dt 2.12.04  
(i + 1 kopij)  
Kudim i As.  
J. Baboume dt  
3.12.04

REPUBLICA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERISË TIRANË  
Nr. 14241 Rep.  
Nr. \_\_\_\_\_ Kol.

### V Ë R T E T I M

Sot më datë 03.12 2004, para meje noterit Agim Robo, Noter pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, u paraqit personalisht Z. Vaid Ruli, me banim në Tiranë, rruga "Gjin Kuqali", Pallati 1, Shkalla 1, Apartamenti 8, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letër njoftimit me nr. EV 218089, me cilësinë e administratorit të shoqërisë tregtare "EDIL CENTRO" Sh.P.K., i cili më deklaroi përmbajtjen e këtij akti të hartuar jashtë kësaj zyre dhe të nënshkruar me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë dhe unë noteri e vërtetova atë sipas ligjit.

NOTER



**SHOQËRIA TREGTARE  
TEGOLA EDIL CENTRO SH.P.K.**



**VENDIM  
I ASAMBLESË SË JASHTËZAKONSHME  
TË ORTAKËVE**

Sot, më datë 03.12.2004, në selinë e shoqërisë tregtare "TEGOLA EDIL CENTRO" Sh.p.k. në Tiranë, u mbajt Mbledhja e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Ortakëve të kësaj shoqërie, me rendin e ditës të bërë të njohur sipas rregullave në fuqi, si më poshtë vijon:

1. Aprovimi i cedimit të kredisë që Shoqëria ZTZ Sh.p.k. ka kundrejt Shoqërisë TEGOLA EDIL CENTRO Sh.p.k., në favor të ortakut të kësaj të fundit, Z. Dario Marcheluzzo.
2. Zmadhimi i kapitalit të shoqërisë;
3. Propozimi për caktimin nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë të ekspertit kontabël të autorizuar për zmadhimin;
4. Të ndryshme.

Asambleja e Ortakëve në prezencë të tre ortakëve të saj që përfaqësojnë kapitalin e shoqërisë në masën 100%, procedoi me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës. Shoqëria TEGOLA EDIL CENTRO Sh.p.k. ka lidhur një kontratë furnizimi me Shoqërinë e së drejtës italiane ndaj të cilës është debitore në vlerën e mbetur pa shlyer. Kreditori, Shoqëria ZTZ Sh.p.k., me anë të marrëveshjes së shkruar i ka ceduar kredinë e tij në Shoqërinë TEGOLA EDIL CENTRO Sh.p.k., Z. Dario Marcheluzzo, ortak i kësaj shoqërie.

*Për pikën e parë të rendit të ditës, Asambleja e Jashtëzakonshme e ortakëve, aprovon cedimin e kredisë së kreditorit Shoqërisë ZTZ Sh.p.k. në favor të Z. Dario Marcheluzzo.*

Më pas Ortakët e Shoqërisë proceduan me diskutimin e pikës së dytë të rendit të ditës, zmadhimin e kapitalit të shoqërisë. Zmadhimi i kapitalit të shoqërisë do të bëhet nëpërmjet kontributit në të holla dhe në natyrë të ortakëve. Kështu Ortaku, Shoqëria Vectis Ansalt do të japë një kontribut në të holla për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë. Ndërsa, përfituesi i cedimit të kredisë që Shoqëria ZTZ Sh.p.k. ka kundrejt Shoqërisë TEGOLA EDIL CENTRO Sh.p.k., Z. Dario Marcheluzzo, ka deklaruar sipas deklaratës noteriale të datës 02.12.2004 se ka hequr dorë nga kërkimi i kredisë, me qëllim që kjo kredi të kalojë për zmadhim kapitali.

Së fundi, Shoqëria "Edil Centro" Sh.p.k. ortake e shoqërisë, me qëllim zmadhimin e kapitalit të shoqërisë TEGOLA EDIL CENTRO SH.p.k. do të japë kontributin e saj në të holla dhe kontribut në natyrë. Ortakja, Shoqëria EDIL CENTRO Sh.p.k., më datë 06.12.2003 ka miratuar pjesmarrjen në operacionin e sipërpërmendur me kontribut në të holla dhe kontribut në natyrë. Kontributi në natyrë i përbërë nga 7500 m<sup>2</sup>, terren së bashku me ndërtesat e ndodhura të dhe që përbëhet nga ish kaldaja e rikonstruktuar dhe

makineritë e inndodhura në të, është vlerësuar me raportin e hartuar nga ekspertët vlerësues të caktuar me vendim gjykatë. Ky kontribut i përfaqësuar nga kjo pasuri e paluajtshme, si pasqyrë e zmadhimit të kapitalit, do të kalojë në pronësi të Shoqërisë TEGOLA EDIL CENTRO Sh.p.k.

*Asambleja e Ortakëve pas një diskutimi të pikës së dytë të rendit të ditës, miraton operacionin e zmadhimit të kapitalit të shoqërisë nëpërmjet kontributit në të holla dhe në natyrë.*

Më pas Asambleja mori në shqyrtim pikën e tretë të rendit të ditës. Zmadhimi i kapitalit të shoqërisë në mënyrën e përcaktuar në pikën e parë, të miratuar nga ortakët, kërkon caktimin e një eksperti kontabël të autorizuar, i cili do të përcaktojë vlerën e zmadhimit të kapitalit dhe përqindjen e pjesmarrjes së secilit ortak në kapitalin e shoqërisë. Për këtë arsye, ortakët propozojnë caktimin nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë të ekspertës kontabël të autorizuar Znj. Sanie Tafa.

Në përfundim të mbledhjes Asambleja e Ortakëve, në mbështetje dhe me Statutin e shoqërisë dhe të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare",

#### VENDOSI:


- 1- Të aprovojë cedimin e kredisë që ka Shoqëria ZTZ Sh.p.k. kundrejt Shoqërisë TEGOLA EDIL CENTRO Sh.p.k. në favor të ortakut të kësaj të fundit Z. Dario Marcheluzzo.
- 2- Të zmadhojë kapitalin e shoqërisë, nëpërmjet kontributit në të holla dhe në natyrë të ortakëve të saj.
- 3- Të propozojë caktimin e ekspertës kontabël të autorizuar Znj. Sanie Tafa për hartimin e raportit përkatës për zmadhimin e kapitalit.
- 4- Të ngarkojë administratorin e shoqërisë Z. Vaid Ruli për depozitimin e këtij vendimi për zmadhimin e kapitalit dhe caktimin e ekspertit në gjykatë.

#### ORTAKËT

SHOQËRIA VECTIS ANSALT

Përfaqësuar nga

Augusto NIDOLI


AUGUSTO NIDOLI  



SHOQËRIA EDIL CENTRO SH.P.K.

Përfaqësuar nga

Vaid RULI

Dario MARCHELUZZO  
MARENGUOLO DARIO






REPUBLICA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE  
Nr. 1423 Rep.  
Nr. 1041 Kol.

### VERTETIM

Sot më datë 03.12 2004, para meje noterit Agim Robo, Noter pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, u paraqitën personalisht Z. Vahid Ruli, i datëlindjes 01.12.1961, banues në Tiranë, në adresën Rruga "Gjike Kuqali", Pall. 1, Sh. 1, Ap. 8, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. EV 218089, administrator i Shoqërisë "EDIL CENTRO" Sh.p.k., Shoqëri e regjistruar në Gjykatën e Rrethit Tiranë me Vendimin nr. Nr. 14434, datë 01.04.1996, me cilësinë e ortakës të Shoqërisë "TEGOLA EDIL CENTRO" Sh.p.k., Dario MARCHELUZZO, shtetas italian, i datëlindjes 13.02.1947, me rezidencë në Costabissara, Vicenza, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. Y 134463, me cilësinë e ortakut themlues të shoqërisë "TEGOLA EDIL CENTRO" Sh.p.k. dhe Z. Augusto Nidoli, lindur në Addis Abeba më 11 Gusht 1941, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me cilësinë e përfaqësuesit me autorizim të Shoqërisë Tregtare "Vectis Ansalt", shoqëri e së drejtës së litenshtejnit, regjistruar pranë Regjistrimit Tregtar të Vaduz me nr. H. 990/8, datë 23.12.1996, me cilësinë e ortakës themeluese të Shoqërisë "TEGOLA EDIL CENTRO" Sh.p.k., të cilët më deklaruan përmbajtjen e këtij akti të hartuar jashtë kësaj zyre, dhe të nënshkruar me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe une noter i vërtetova atë sipas ligjit.







**SOL.INT.**  
Soluzione integrale  
Via Bertesina 5. 36 100 Vicenza

**Vicenza, 2 qershor 2004**

Shoqëria Sol Int., me seli ligjore në Vicenza (Itali), Rruga Bertesina 5, 36 100 Vicenza, nëpërmjet Administratorit të Vetëm të saj Z. Giuliano Zoso, në cilësinë e ortakës së Shoqërisë “EDIL CENTRO” Sh.p.k., me seli në Tiranë (Shqipëri),

### **AUTORIZON**

Z. Augusto Nidoli, lindur në Addis Abeba më 11 gusht 1941, për të përfaqësuar Shoqërinë me rastin e Asambleve të Ortakëve të EDIL CENTRO SH.p.k., që do të mbledhen më 16 qershor 2004, pranë selisë së shoqërisë në Tiranë për të vendosur mbi çështjet e përcaktuara në rendin e ditës:

Për Asamblenë e parë të Ortakëve:

- Miratimi i zgjerimit të objektit të Shoqërisë TEGOLA EDIL CENTRO Sh.p.k., në të cilën shoqëria EDIL CENTRO zotëron 16% të kuotave;
- Të ndryshme


Për Asamblenë e Jashtëzakonshme të Ortakëve:

- Zgjerimi i objektit të shoqërisë EDIL CENTRO Sh.p.k.;
- Për një ndryshim në Statut;
- Të ndryshme.

Z. Augusto Nidoli ka të drejta të plota për të diskutuar dhe miratuar vendimet përkatëse, në emër dhe për llogari të shoqërisë Sol. Int. S.r.l.

**ADMINISTRATORI I VETËM**

**Giuliano ZOSO**

  
REPUBLIKA E SHQIPERISE  
NOTERIA TIRANE  
N. ...11530... Rep.


VERTETIM

Une i neneshkruari, Agim Xh. Robo, noter ne qytetin e Tiranes, Rruga Ismail Qemali, P. 27/1, vertetoj se kam perkthyer sa me siper nga italishtja ne shqip njelloj me origjinalin.

Tirane, me ...29.08.2004

NOTERI

Agim XH. ROBO



TEGOLA EDIL CENTRO SH.P.K.  
PRODHIM TJEGULLA  
Rr. Vangjel Noti, Laprake, Tirane  
TEL 00355-4-355937, Fax-04-357728Cel-0682020595  
zyre 0680258139

Tirana, il 01.06.2004

Ai soci di  
TEGOLA EDIL CENTRO sh.p.k.

Loro sedi

VECTIS ANSALT  
EDIL CENTRO SH.P.K.  
Sig. Dario MARCHELUZZO

E indetta per il giorno 18.06.2004 alle ore 14.00 presso la sede sociale, via Vangjel Noti,  
Laprak, Tirana

#### L'ASSEMBLEA STRAORDINARIA DEI SOCI


Per deliberare circa il seguente ordine del giorno:

- 1- L'ampliamento dell' oggetto sociale;
- 2- Modifiche allo Statuto;
- 3- Vari ed eventuali.

I signori soci sono pregati di voler intervenire data l'importanza delle decisioni da prendere, in alternativa sono pregati di voler inviare delega

**Distinti saluti,**

**L'AMMINISTRATORE**

Vaid ROLI  




TEGOLA EDIL CENTRO SH.P.K.  
PRODHIM TJEGULLA  
Rr. Vangjel Noti, Laprake, Tirane  
TEL 00355-4-355937, FAX – 04-357728 CEL 0682020595  
zyre 068258139

Tiranë, më 01.06.2004

Ortakëve të  
TEGOLA EDIL CENTRO Sh.p.k.

Në selitë e tyre

VECTIS ANSALT  
EDIL CENTRO SH.P.K.  
z. Dario MARCHELUZZO

Është vendosur thëritja më datë 18.06.2004, ora 14.00, pranë selisë të shoqërisë Rruga Vangjel Noti, Laprak Tiranë,

#### ASAMBLEA E JASHTËZAKONSHME E ORTAKËVE

Për të vendosur rreth rendit të ditës si më poshtë vijon:

1. Zgjerimi i objektit të Shoqërisë;
2. Ndryshime në Statut;
3. Të ndryshme.

Zotërinjtë ortak janë të lutur të marrin pjesë për shkak të rëndësisë së vendimeve që duhen marrë, dhe si alternativë mund të dërgojnë autorizimet

Me respekt

ADMINISTRATORI

Vaid RULI



REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA TIRANE

N. ...12182... Rep.

VERTETIM

Une i neneshkruari, Agim Xh. Robo, noter ne qytetin e Tiranës, Rruga Ismail Qemali, P. 27/1, vertetoj se kam perkthyer sa me siper nga italishtja ne shqip njelloj me originalin.

Tirane, me 11.10.2004

NOTERI



Edilcentro sh.p.k.  
PRODHIM TULLA -TUBA PVC  
Rr. Vangjel Noti, Laprake, Tirane  
TEL 00355-4-355937, Fax-04-357728Cel-0682020595  
E-MAIL: [edilcen@icc.al.eu.org](mailto:edilcen@icc.al.eu.org) zyre 0680258139  
N.I.P.T: 361811017

Tirana, il 01.06.2004

Ai soci di  
EDILCENTRO sh.p.k.

Loro sedi  
SOL.INT.srl  
FINEST SPA  
Vectis ansalt  
Sig. Vaid Ruli  
Sig. Antonio Nidoli  
Sig. Leonardo Nidoli  
Sig.ra Sarah Nidoli



E indetta per il giorno 16.06.2004 alle ore 14.00 presso la sede sociale, via Vangjel Noti, Laprak, Tirana

#### L'ASSEMBLEA DEI SOCI

Per deliberare circa il seguente ordine del giorno:


1. L'ampliamento dell' oggetto sociale della TEGOLA EDIL CENTRO;
2. Vari ed eventuali.

I signori soci sono pregati di voler intervenire data l'importanza delle decisioni da prendere, in alternativa sono pregati di voler inviare delega

Distinti saluti,

L'AMMINISTRATORE

Vaid RULI



REPUBLIKA SHQIPËRISE  
DHOMA E NOTEREVE TIRANË  
Nr 2270 Dep Dt 12/10/04  
VERTETIM  
Vertetimi i dokumenteve është e  
njështetshme me origjinalin. Dokumenti  
U Perdorur T. Hyqori  
Nr Pasap  
NOTER AGIM ROBO



Edilcentro sh.p.k.  
PRODHIM TULLA -TUBA PVC  
Rr. Vangjel Noti, Laprake, Tirane

TEL 00355-4-355937, Fax-04-357728 Cel-0682020595

E-MAIL: [edilcen@icc.al.eu.org](mailto:edilcen@icc.al.eu.org) zyre 0680258139

N.I.P.T: 361811017

Tiranë, më 01.06.2004

Ortakëve të  
EDIL CENTRO Sh.p.k.

Në selitë e tyre  
SOL.INT.sh.p.k.  
FINEST SPA  
Vectis ansalt  
Z. Vaid Ruli  
Z. Antonio Nidoli  
Z. Leonardo Nidoli  
Znj. Sarah Nidoli

Është vendosur thërritja më datë 16.06.2004 ora 14.30 pranë selisë së Shoqërisë rruga Vangjel Noti, Laprakë, Tiranë;

#### ASAMBLEA E ORTAKËVE

Për të vendosur rreth rendit të ditës si më poshtë vijon:

1. Zgjerimi i objektit të Shoqërisë TEGOLA EDIL CENTRO;
2. Të ndryshme.

Zotërinjtë ortak janë të lutur të marrin pjesë për shkak të rëndësisë së vendimeve që duhen marrë dhe si alternativë mund të dërgojnë autorizime.

Me respekt

ADMINISTRATORI

Vaid RULI

REPubLIKA E SHQIPERISE  
NOTERIA TIRANE  
N. 12271 Rep.

VERTETIM

Une i neneshkruari, Agim Xh. Robo, noter ne qytetin e Tiranes, Rruga Ismail Qemali, P. 27/1, vertetoj se kam perkthyer sa me siper nga italishtja ne shqip njelloj me originalin.  
Tirane, me 12.10.2004

NOTERI





20 SH. B. MUSA  
26.06.2004  
107

30387/A  
mm

**KËRKESË**

**KËRKUES:** Shoqëria Tregtare "TEGOLA EDIL CENTRO" sh.p.k., përfaqësuar nga administratori i Shoqërisë Z.Vaid Ruli, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

**OBJEKTI:** Depozitimi i vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Ortakëve të datës 18.06.2004, për zgjerimin e objektit të shoqërisë dhe ndryshimin e dispozitës përkatëse të Statutit.

**PËRPARA GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË**

**TIRANË**

**I nderuar Zoti Kryetar,**

Shoqëria Tregtare "TEGOLA EDIL CENTRO" sh.p.k. është regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë me vendimin nr.30387, datë 14.10.2003 dhe ushtron aktivitetet e saj sipas akteve të themelimit.

Me cilësinë e administratorit të shoqërisë, paraqes këtë kërkesë përpara kësaj gjykate për depozitimin e Vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Ortakëve të datës 18.06.2004.

Me anë të këtij vendimi, Asamblea e Jashtëzakonshme e Ortakëve, ka vendosur zgjerimin e objektit të veprimtarisë së shoqërisë, për përshtatjen e këtij me ecurinë që ka patur aktiviteti i shoqërisë. Për sa më sipër është vendosur dhe ndryshimi i dispozitës përkatëse të Statutit

Ky vendim është marrë në bazë të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992, "Për Shoqëritë Tregtare" dhe Statutit të shoqërisë. Për këto arsye kërkojmë depozitimin e vendimit të mësipërm të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Ortakëve, datë 18.06.2004.

**KËRKUES**

**ADMINISTRATORI**

**Vaid RULI**

*Bi def @*  
*10*  
*Vendim i B*  
*J. Jakovci me*  
*datë 18.6.04*  
*Vendim i K. Adur*  
*me*  
*datë 10.6.04*  
*Vendim i B. Oti*  
*i Edil Centro*  
*datë 16.6.04*






REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERISË TIRANË  
Nr. 11026 Rep.  
Nr. — Kol.

## VËRTETIM

Sot më datë 16.08, 2004, para meje noterit Agim Robo, Noter pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, u paraqit personalisht Z. Vaid Ruli, me banim në Tiranë, rruga "Gjin Kuçali", Pallati 1, Shkalla 1, Apartamenti 8, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letër njoftimit me nr. EV 218089, me cilësinë e administratorit të shoqërisë tregtare "TEGOLA EDIL CENTRO" Sh.P.K., i cili më deklaroi përmbajtjen e këtij akti të hartuar jashtë kësaj zyre dhe të nënshkruar me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë dhe unë noteri e vërtetova atë sipas ligjit.



**SHOQËRIA TREGTARE  
“TEGOLA EDIL CENTRO” SH.P.K**



**VENDIM**

**I ASAMBLESË SË JASHTËZAKONSHME  
TË ORTAKËVE**

Më datë 18.06.2004, në selinë e Shoqërisë Tregtare “TEGOLA EDIL CENTRO” sh.p.k në Tiranë u mbledh asamblea e ortakëve, për të shqyrtuar rendin e ditës si më poshtë:

1. Zgjerimi i objektit të shoqërisë;
2. Për një ndryshim në Statut;
3. Të ndryshme.

Asamblea e Ortakëve, në prezencë të të gjithë ortakëve të shoqërisë, Shoqërisë “EDIL CENTRO” Sh.p.k., të përfaqësuar nga administratori i saj Z. Vaid Ruli, sipas Vendimit të Asamblesë, datë 16.06.2004, Z. Dario Marcheluzzo dhe Shoqërisë VECTIS ANSALT, përfaqësuar nga Presidenti i Këshillit Administrativ Z. Renzo Forni, procedoi me shqyrtimin e rendit të ditës. Asamblea konstatoi se aktiviteti i shoqërisë, kërkon zgjerim të mëtejshmëm, kjo në përputhje me kërksat e tregut.

Për këtë arsye propozohet shtimi i objektit të veprimtarisë. Kjo do të ndihmojë në zhvillimin dhe rritjen e treguesve ekonomikë të shoqërisë.

Kështu asamblea, në mbështetje me legjislacionin tregtar në fuqi, vendosi të bëjë shtimin si më poshtë vijon:

*“Aktivitetet minerar, shfrytëzim mineralesh, punë me lëndë plasëse, transportimi dhe magazinimi i tyre.”*

***Asamblea e Ortakëve miraton me unanimitet zgjerimin e objektit të veprimtarisë së shoqërisë në mënyrën e përcaktuar më sipër.***

Gjithashtu Asamblea pas këtij operacioni, sipas pikës së dytë të rendit të ditës vendosi të ndryshojë nenin e Statutit në këtë mënyrë:

**Neni 1 i Statutit me këtë përmbajtje**

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë:

- Prodhimin e tjeçullave të ndërtimit, si dhe import – eksportimin e tyre;
- Projektimi, shërbim dhe ekspertizë për fushat: për godina banimi, godina social-kulturore dhe industriale të të gjitha kategorive, punime e ndërtime portuale, shtrim dhe asfaltim rruge e sheshe ura, ujsjellësa, linja elektrike, kanalizime të ujrave, instalime hidro-sanitare, ngrohje dhe ventilim, instalime elektrike, telefoni, citofoni e televizive dhe instalime e montime të konstruksioneve e pajisjeve, e makineri të ndryshme, studime urbanistike të pjesshme dhe të plota;

- Tregtim dhe dhënie me qera të apartamenteve, dyqaneve, parkinge, magazina, sheshe dhe troje ndërtimi;
- Aktivitet industrial, prodhim dhe tregtim të artikujve: të materialeve të ndërtimit, ushqimore dhe industriale, farmaceutike, elektro-shtëpiake, gaz natyror, duhan, pije alkoolike dhe freskuese, fruta dhe perime, artikuj bujqësor dhe blektoral, pajisje makineri, automjete dhe pjesë të këmbimit për to, si dhe çdo lloj artikulli tjetër me objekt shit-blerje me shumicë dhe pakicë në eksport dhe import, hapja restorante, kafeteri, bare, diskoteka, hoteleri dhe në vende turistike dhe tregtimi në to të çdo lloj malli, kambizëm, konsultim biznesi dhe të tjerë, etj.;
- Hapje dhe zhvilli të aktivitetit edukativ dhe arsimor për çerdhe, kopësht dhe shkolla private të të gjitha niveleve;
- Veprimtari transporti mallrash dhe njerëzish për brenda dhe jashtë vendit si dhe zhvillimi i aktivitetit riparues për automjetet e ndryshme nëpërmjet pikave të riparimit dhe serviseve.

**Ndryshon në këtë mënyrë:**

Shoqëria do te ketë si objekt të veprimtarisë:

- Prodhimin e tregullave të ndërtimit, si dhe import – eksportimin e tyre;
- Projektimi, shërbim dhe ekspertizë për fushat: për godina banimi, godina social-kulturore dhe industriale të të gjitha kategorive, punime e ndërtime portuale, shtrim dhe asfaltim rruge e sheshe ura, ujsjellësa, linja elektrike, kanalizime të ujrave, instalime hidro-sanitare, ngrohje dhe ventilim, instalime elektrike, telefoni, citofoni e televizive dhe instalime e montime të konstruksioneve e pajisjeve, e makineri të ndryshme, studime urbanistike të pjesshme dhe të plota;
- Tregtim dhe dhënie me qera të apartamenteve, dyqaneve, parkinge, magazina, sheshe dhe troje ndërtimi;
- Aktivitet industrial, prodhim dhe tregtim të artikujve: të materialeve të ndërtimit, ushqimore dhe industriale, farmaceutike, elektro-shtëpiake, gaz natyror, duhan, pije alkoolike dhe freskuese, fruta dhe perime, artikuj bujqësor dhe blektoral, pajisje, makineri, automjete dhe pjesë të këmbimit për to, si dhe çdo lloj artikulli tjetër me objekt shit-blerje me shumicë dhe pakicë në eksport dhe import, hapja restorante, kafeteri, bare, diskoteka, hoteleri dhe në vende turistike dhe tregtimi në to të çdo lloj malli, kambizëm, konsultim biznesi dhe të tjerë, etj.;
- Hapje dhe zhvilli të aktivitetit edukativ dhe arsimor për çerdhe, kopësht dhe shkolla private të të gjitha niveleve;
- Veprimtari transporti mallrash dhe njerëzish për brenda dhe jashtë vendit si dhe zhvillimi i aktivitetit riparues për automjetet e ndryshme nëpërmjet pikave të riparimit dhe serviseve;
- *Aktivitet minerar, shfrytëzim mineralesh, punë me lëndë plasëse, transportimi dhe magazinimi i tyre.*

***Ortakët me unanimitet miratojnë ndryshim e nenin 1 të Statutit si më sipër.***

Asambela pas një diskutimi të gjerë dhe duke mos patur asnjë pikë tjetër për diskutim, pas konsultimeve me me aktet e themelimit dhe legjislacionin tregtar në fuqi, me unanimitet,

## VENDOSI:

1. Të shtojë objektin e shoqërisë si më poshtë vijon;  
*“Aktiviteti mineralar, shfrytëzim mineralësh, punë me lëndë plasëse, transportimi dhe magazinimi i tyre”*
2. Të miratojë ndryshimin e dispozitës përkatëse të Statutit si më sipër;
3. Të ngarkojë Administratorin e shoqërisë Z. Vaid Ruli me ndjekjen e procedurave të depozitimit të këtij vendimi në Gjykatë;

## ORTAKËT THEMELUES

**Shoqëria “EDIL CENTRO” Sh.p.k.**

Përfaqësuar nga


**Vaid RULLI**



**Shoqëria VECTIS ANSALT**

Përfaqësuar nga

**Renzo FORNI**



**Dario MARCHELUZZO**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERISË TIRANË  
Nr. 1515 Rep.  
Nr. 798 Kol.

### V Ë R T E T I M

Sot më datë 24.09 2004, para meje noterit Agim Robo, Noter pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, u paraqitën personalisht Z. Vahid Ruli, i datëlindjes 01.12.1961, banues në Tiranë, në adresën Rruga "Gjike Kuqali", Pall. 1, Sh. 1, Ap. 8, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. EV 218089, administrator i Shoqërisë "EDIL CENTRO" Sh.p.k., Shoqëri e regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr. Nr. 14434, datë 01.04.1996, me cilësinë e ortakes të Shoqërisë "TEGOLA EDIL CENTRO" Sh.p.k., Z. Dario MARCHELUZZO, shtetas italian, i datëlindjes 13.02.1947, me rezidencë në Costabissara, Vicenza, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. Y 134463, me cilësinë e ortakut të shoqërisë "TEGOLA EDIL CENTRO" Sh.p.k. dhe Z. Renzo Forni, shtetas italian, i datëlindjes 16.12.1936, lindur ne Villa Luganese, mbajtës i pasaportes me nr. 0824595, Presidenti i Këshillit Administrativ të Shoqërisë Tregtare "Vectis Ansalt", shoqëri e së drejtës së litenshtejnit, regjistruar pranë Regjistrat Tregtar të Vaduz me nr. H. 990/8, datë 23.12.1996, me cilësinë e ortakes të Shoqërisë "TEGOLA EDIL CENTRO" Sh.p.k., të cilët më deklaruan përmbajtjen e këtij akti të hartuar jashtë kësaj zyre, dhe të nënshkruar me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe unë noteri e vërtetova atë sipas ligjit.



**SHOQËRIA TREGTARE  
VECTIS ANSALT**

**VENDIM**



Sot më datë 10.06.2004, Presidenti i Këshillit Administrativ të Shoqërisë VECTIS ANSALT, u mbodh në Selinë e shoqërisë për të diskutuar dhe vendosur mbi e rendim e ditës si më poshtë vijon:

1. Miratimi i operacionit të zgjerimit të objektit të Shoqërisë EDIL CENTRO Sh.p.k., në të cilën shoqërisë zotëron 37.7% të kuotave.
2. Miratimi i operacionit të zgjerimit të objektit të Shoqërisë "TEGOLA EDIL CENTRO" Sh.p.k, në të cilën shoqëria zotëron 75,7272% të kuotave.
3. Të ndryshme.

Pas shqyrtimit të rendit të ditës, Shoqëria VECTIS ANSALT,

**VENDOSI:**

- Presidenti i Këshillit Administrativ të shoqërisë pasi u njoh me propozimin e Shoqërisë EDIL CENTRO Sh.p.k. për shtimin e objektit të veprimtarisë së kësaj të fundit miraton propozimin.

Propozimi më pas i miratuar ka këtë formulim:

*"Aktivitetet minerar, shfrytëzim mineralesh, punë me lëndë plasëse, transportimi dhe magazinimi i tyre".*

- Shoqëria Vectis Ansalt, duke marrë shkas nga ky ndryshim në objekt, jep miratimin dhe për ndryshimin përkatës në nenin 7 të Statutit të Shoqërisë "EDIL CENTRO" sh.p.k.

- Presidenti i Këshillit Administrativ të shoqërisë pasi u njoh me propozimin e Shoqërisë TEGOLA EDIL CENTRO sh.p.k. për shtimin e objektit të veprimtarisë së kësaj të fundit miraton propozimin.

Propozimi më pas i miratuar ka këtë formulim:

*"Aktivitetet minerar, shfrytëzim mineralesh, punë me lëndë plasëse, transportimi dhe magazinimi i tyre".*

- Shoqëria Vectis Ansalt, duke marrë shkas nga ky ndryshim në objekt, jep miratimin dhe për ndryshimin përkatës në nenin 1 të Statutit të Shoqërisë "TEGOLA EDIL CENTRO" Sh.p.k.

Shoqëria VECTIS ANSALT, do të përfaqësohet nga Presidenti i Këshillit Administrativ Z. Renzo Forni në Asamblenë e Shoqërisë Tregtare "EDIL CNETRO" Sh.p.k., e cila do të mbahet më datë 16.06.2004 dhe në Asamblenë e Shoqërisë "TEGOLA EDIL CENTRO" Sh.p.k. që do të mbahet më datë 18.06.2004, të dyja me me këtë rend dite:

1. Zgjerimi i objektit të shoqërisë;
2. Për një ndryshim në Statut;
3. Të ndryshme.

Z. Renzo Forni ka të drejtën për të diskutuar, vendosur dhe nënshkruar vendimet në emër dhe për llogari të shoqërisë VECTIS ANSALT.

**VECTIS ANSALT**  
Presidenti i Këshillit Administrativ

**Renzo Forni**

**VECTIS ANSALT**  
FL-9490 VADUZ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERISË TIRANË  
Nr. 1123 Rep.  
Nr. 802 Kol.

REPUBLIKA SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERËVE TIRANË  
Nr. 1163 Rep. Dt 28/9/04  
VËRTETIM

Vërtetimi në shtetësi mbajtës  
nëse në origjinalin Dokumenti  
U Pasaqit  
Nr Pasaqit  
NOTER AGIM ROBO



VËRTETIM

Sot më datë 24.09.2004, para meje noterit Agim Robo, Noter pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, u paraqitn personalisht Z. Renato Pomi, shtetas italian, i datëlindjes 16.12.1936, lindur në Villa Luganese, mbajtës i pasaportes me nr. 0824595, Presidenti i Këshillit Administrativ të Shoqërisë Tregtare "Vectis Ansal", shoqëri e së drejtës së litenshtejmit, regjistruar pranë Regjistrat Tregtar të Vaduz me nr. H. 990/8, datë 23.12.1996, të cilin më deklaroi përmbajtjen e këtij akti të hartuar jashtë kësaj zyre, dhe të nënshkruar me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë dhe unë noteri e vërtetova atë sipas ligjit. Teksi ju lexua në italisht nënshkruesit prej meje noterit

NOTER



100  
LEKE  
RISHQIPËRISË





**VENDIM**  
**I**  
**ASAMBLESE SË ORTAKËVE**

Më datë 16.06.2004, në selinë e Shoqërisë Tregtare "EDIL CENTRO" sh.p.k në Tiranë u mbledh asamblea e ortakëve, për të shqyrtuar rendin e ditës si më poshtë:

1. Miratimi i zgjerimit të objektit të shoqërisë "TEGOLA EDIL CENRTO" Sh.p.k., në të cilën shoqëria është ortakë me 16% të kuotave;
2. Të ndryshme.

Asamblea e Ortakëve, në prezencë të të gjithë ortakëve të shoqërisë, Shoqëria "Vectis Anstalt", përfaqësuar nga Presidenti i Këshillit Administrativ Z. Renzo Forni, Shoqëria "Sol. Int." Sh.p.k., përfaqësuar sipas autorizimit të datës 02.06.04 nga Z. Augusto Nidoli, Z. Antonio Nidoli, Z. Leonardo Nidoli, Znj. Sarah Nidoli dhe Z. Vahid Ruli, procedoi me shqyrtimin e rendit të ditës, sipas pikës së parë të saj.

Shoqëria "TEGOLA EDIL CENTRO" Sh.p.k., në të cilën Shoqëria "EDIL CENTRO" Sh.p.k. zotëron 16% të kuotave ka ndërmarrë operacionin për zgjerimin e objektit të saj të veprimtarisë. Sipas propozimit përkatës, është paraqitur për miratim shtesa e objektit me përmbajtje si më poshtë vijon:

*"Aktivitet minerar, shfrytëzim mineralesh, punë me lëndë plasëse, transportimi dhe magazinimi i tyre."*

Për sa më sipër, ortakët e shoqërisë "EDIL CENTRO" Sh.p.k. miratojnë me unanimitet zgjerimin e objektit të Shoqërisë Tregtare "TEGOLA EDIL CENTRO" Sh.p.k.

Gjithashtu ortakët japin miratimin e tyre dhe për ndryshimin e nenin 1 të Statutit të shoqërisë së përmendur më lart, si rrjedhojë e shtesës në objekt.

Së fundi ortakët autorzojnë administratorin e shoqërisë Z. Vaid Ruli për të përfaqësuar shoqërinë në mbledhjen e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Shoqërisë "TEGOLA EDIL CENTRO" e cila do të zhvillohet më datë 18.06.2004 me këtë rend dite:

1. Zgjerimi i objektit të shoqërisë;
2. Për një ndryshim në Statut;
3. Të ndryshme.

Administratorit i jepet e drejta për të diskutuar, vendosur dhe nënshkruar vendimet përkatëse sipas rendit të ditës të asamblesë.

Asamble e Ortakëve të Shoqërisë "EDIL CENTRO" Sh.p.k., në përfundim të mbledhjes dhe në mbështetje me ligjin,

## VENDOSI:

1. Të miratojë zgjerimin e objektit të shoqërisë "TEGOLA EDIL CENRTO" Sh.p.k., në të cilën shoqëria është ortakë me 16% të kuotave në këtë mënyrë;  
*Aktivitetë minerar, shfrytëzim mineralësh, punë me lëndë plasëse, transportimi dhe magazinimi i tyre"*

2. Të japë pëlqimin e saj për ndryshimin e nenit 1 të Statutit të Shoqërisë si më sipër pas shtesës në objekt dhe sipas kësaj shtese;
3. Të autorizojë Administratorin e shoqërisë për të përfaqësuar atë në mbledhjen e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Shoqërisë "TEGOLA EDIL CENTRO" Sh.p.k., duke i dhënë të drejtë për të diskutuar vendosur dhe nënshkruar vendimin, sipas rendit të ditës të bërë të njohur.

## ORTAKËT

**SOL. INT. SRL**

Përfaqësuar nga

**Augusto NIDOLI**

**Vaid RULI**

**Sarah NIDOLI**

**VECTIS ANSTALT**

Përfaqësuar nga

**Renzo FORNI**

**Antonio NIDOLI**

**Leonardo NIDOLI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. 11525 Rep.  
Nr. 803 Kol.

VËRTETIM

